



Një ankesë kundër: **Komuna e Gjakovës**

(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **632-16-081-511**

(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për: **"Ndërtimi i Rrugës Bujar Roka – pjesa jugore e qytetit në Gjakovë"**

(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

PE-VLA-KU sh.p.k.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Jakov Xoxa, L-A, K-7, Nr.54

(Adresa)

Prishtinë

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

049 20 10 30

(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

Kujtim Arifaj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

pevlaku.ks@gmail.com

(Adresa elektronike)

24/05/2017

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vlerë)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me **PROKURË**.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) (Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) (Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Data e parë e njoftimit të kontratës ne KRPP: **30/12/2016**

Afati për dorëzim të tenderit: **10/02/2017**

Data dhe ora e fillimit të procesit të hapjes së tenderit: **10/02/2017, ora 14:00**

Kriteri për dhënie të kontratës: **Cmimi më i ulët**

Njoftim për dhënie të kontratës ne KRPP: **17/03/2017**

Vendimi i OSHP 81/17,86/17,91/17: **02/05/2017**

Njoftim për eliminim si tenderues i pasuksesshem: **08/05/2017**

Njoftim për dhënie të kontratës Rivlersim: **11/05/2017**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

| | | | | | | | | |
|----|--------------------------|--|--|--|--|----|-------------------------------------|--|
| Po | <input type="checkbox"/> | | | | | Jo | <input checked="" type="checkbox"/> | |
|----|--------------------------|--|--|--|--|----|-------------------------------------|--|

| |
|--|
| |
|--|

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

| | | | | | |
|----|--|--|--|----|--------------------------|
| Po | <input checked="checked" type="checkbox"/> | | | Jo | <input type="checkbox"/> |
|----|--|--|--|----|--------------------------|

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-se - Qellimi

Neni 7 i LPP-se – Barazia në Trajtim/ Jo Diskriminim

Neni 6 i LPP-se – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 59 i LPP-se - Ezaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tendereve

Neni 72 i LPP-se - Dokumentacioni shtesë

Neni 60 par.1 pika 1 i LPP-se – Kriteret për dhënie të Kontrates

Neni 108/A i LPP-se – Zgjidhja preliminare e mosmarrveshjeve

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Gjatë procedurës së aktivitetit të prokurimit Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të Ligjit për Prokurim Publik, perkatesisht neneve të lartcekura duke devijuar nga kriteret e vendosura në Dosjen e Tenderit.

Me datën 17/03/2017 kemi pranuar email nga Autoriteti Kontraktues përmes së cilit jemi njoftuar që jemi shpallur tenderues i suksesshem dhe na është dhënë tenderi në fjalë.

Pas ankesave të disa Operatorve Ekonomik të parashtruara pranë Autoritetit Kontraktues dhe në OSHP, lenda është kthyer në Ri vlersim.

Me datën 08/05/2017 kemi pranuar një email ku jemi eliminuar si tenderues i pasuksesshem.

Duke u bazuar në arsyetimet të cilat na janë dhënë të cilat tregojnë se pse në jemi shpallur tenderues i pasuksessesh na bënte të kuptojmë që Autoriteti Kontraktues shkelur ligjin e prokurimit publik.

Arsyet e eliminimit si në vijim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

-Në bazë të vendimit të OSHP-së me nr. 81/17, 86/17, 91/17 të datës 02.05.2017, paneli shqyrtues i ka pranuar si të bazuara 3 pretendime ankimore të OE N.N.T.SH. DRINI COMPANY Sh.p.k

...

Në bazë të vendimit të OSHP-së, ju si OE jeni të papërgjegjshëm pasi që ju nuk keni plotësuar kushtet e dosjes tenderit. Nuk keni dorëzuar certifikatë EN, keni dorëzuar trupë ndriqes me jetëgjatësi më të vogël se sa që është kërkuar në dosje tenderit si dhe keni dorëzuar kataloge në gjuhë jo zyrtare – Italiane.

Sa i perket arsyes pare te eliminimit qe nuk kemi ofruar certifikata EN, vlen te theksohet se Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te Nenit 72 te LPP-se sepse duke u bazuar ne kete ligj AK ka mundur te kerkoj dokumente sqaruese, pasi qe ne kemi paraqitur ne dosjen e tenderit certifikata EN nga kompania "GE Lighting" por i kemi paraqitur ne gjuhen Italiane.

Sikur te respektohej neni 72 nga AK sigurisht qe ne do te kishim ofruar te dhenat edhe ne Gjuhen Angleze apo cfardo gjuhe qe do te kerkohej nga AK, dhe jo vetem qe kjo perben shkelje te nenit 72 por kjo perben edhe shkeljen e rregullave te lojalitetit te tregut dhe barazis ne konkurueshmeri e aq me shume kur dihet se kerkesa ne artikul perkatesisht standardet e kerkuar nuk ka prodhim vendor dhe si te tilla ateher nese nuk lejohen te dhenat ne gjuhen italiane ne do ti ofronim ne gjuhe tjera sipas nevojës se AK.

Me kete rast bashkelidhur do te gjeni deklaratat e konformitetit, permes se ciles prodhuesi deklaroi nen pergjegjsine e tyre qe produktet e ofruara jane ne perputhje me standardet teknike te kerkuara e te cilat jane edhe ne perputhje te plote me standardet teknike te publikuara edhe ne Gazeten zyrtare te Bashimit Evropian, gjithashtu direktivave dhe rregulloreve te Sekretariati te Energjise ku per me shume duhet te theksohet se Republika e Kosoves eshte anetare e Sekreteriatit te Energjise ne kuader te Bashkimit Evropian ku direktivat e Sekretariatit tanime jane obligative per te gjitha Vendet anetare ne kete raste edhe per RKS. Duhet cekur se te gjithë prodhuesit e te gjitha paisjeve elektrike apo energjetike ne momentin kur licencohen per prodhimin e produkteve me automatizem kane te plotesuar standardin e konformitetit bazuar ne listen e paracaktuar dhe si te tilla jane prezente ne te gjitha tregjet Evropiane dhe Globale e per me shume sa i perket EN certifikatave te kompanise "GE Lighting" si ne vijim:

- Certifikata CE
- Certifikata EN
- Direktiva 2004/108/EC
- Direktiva 2006/95/EC
- Direktiva 2009/125/EC
- Direktiva 1194/2012/EU
- Direktiva 2011/65/EC
- EN 60598, EN 62471, EN 55015, EN 61000, EN 62493, EN 61547

Andaj, me kete raste jo vetem qe jane shkelur regullat e nenit 7 te LPP-se Barazia ne Trajtim/ Jo Diskriminim por jane shkelur edhe direktivat nderkombetare ne kuader te trupave ku shteti jone eshte Anetare.

Sa i perket arsyes se dyte te eliminimit keni dorzuar trupa ndriques me jetegjatesi me te vogel se sa qe eshte kerkuar ne dosje tenderit,

Deklarojme se Prodhuesi per **Trupat Ndricules**, **"GE Lighting"**, (Address: Vdci lit 77.1044 Budapest Hungary) ploteson normat e kerkuara te cilat do ti gjeni bashke lidhur te dokumentuara me Deklaraten e Konformitetit dhe Te dhenat Teknike per produktet e ofruara.

Koment: (Grafiku Bashkelidhur)

Ndriculesi ne 90,000 ore pune shkon me 90% te eficences.

Per jetegjatesi mbi 100,000 duke pare grafikun e meposhtem per 100,000 ore ndricuesi bie vetem 20% ne rendiment pra jetegjatesia ne termin e fikjes eshte shume here me teper ore pune.



Pra ne jemi te sigurt qe Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te Nenit 72 te LPP-se sepse duke u bazuar ne kete ligj Autoriteti Kontraktues ka mundur te kerkoj informata sqaruese apo edhe dokumente sqaruese ku ne menyre te sakte do te konstatohet se kerkesa ne DT eshte e plotesuar ne perpikëmeri te plote ku edhe me kete raste AK po ashtu ka bere shkelje te Nenit 59 te LPP-se Ezaminimin, vleresimin dhe krahasimin e tendereve, pasi qe ne baze te provave te dokumentuara qe do te ja bashkangjesim ankeses deshmojne qe tenderi i ofruar nga ana jone i ploteson kriteret per shperblim me kontrate.

Sa i perket arsyes trete të eliminimit keni dorzuar kataloge ne gjuhe jo zyrtare – Italiane

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te Nenit 72 te LPP-se sepse duke u bazuar ne kete ligj AK ka mundur te kerkoj info sqaruese shtese per nevojat eventuale te AK.

Sigurisht qe ne me kete raste ose do te kishim ofruar te dhenat ne gjuhen Angleze ose do te kishim bere perkthimin ne gjuhen e nevojeshme perms interpreteve te licencuar, sepse ne jemi te bindur se asnje ofertues nuk ka ofruar katalogje ne gjuhet zyrtare kur dihet qe pasjet e kerkuara nuk jane produkte apo prodhime vendore dhe si te tilla nuk mund te kene gjuhen Shqipe si Gjuhe te vendosur ne katalog per kundrazi ne kemi ofruar te dhena te sigurta nga origjina e prodhuesit.

Me kete raste AK prap ne menyre te pa drejt ka konsideruar si mos permblushe e kriterit dhe si e tille kjo perben shkelje te rende te rregullave te LPP-se .

Ne kesaj ankese po i bashkelidhim edhe katalogun ne gjuhen angleze nga kompania “Vernisol”

Nga te cekurat me larte konkludohet se AK ne rastin konkret ka bere shkelje te Nenit 1, 7, 6, 59, 72, 60, 108/A te LPP-se.

Autoriteti Kontraktues ne kete aktivitet te prokurimit ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-se , sepse ka vepruar ne kundërshtim me qellimin e LPP-se sa i perket shfrytezimit te fondeve publike , kur dihet se oferta jone eshte me e lire

mbi 100mije euro ne krahasim me oferten e OE. te rekomanduar per kontrate.

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te nenit 6 te LPP-se sepse nuk ka siguruar qe fondet publike dhe burimet publike te perdoren ne menyre me ekonomike.

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te nenit 59 te LPP-se sepse me rastin e ekzaminimit, vleresimit dhe krahasimit te ofertave ka bere vertetim te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe materiale duke shperblyer operatorin ekonomik i cili ka çmim dukshem me te larte ne krahasim me ofeten tone , ku oferta jone ne baze te deshmive te prezentuara me larte rezulton se eshte e pergjegjeshme.

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te nenit 60 par.1 pika1 te LPP-se , sepse ka shperblyer OE.me çmim me te larte ne krahasim me oferten tone.

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te nenit 72 te LPP-se , sepse nuk ka kerkuar nga kompania jone info shtese pasi qe lenda eshte kthyer ne Rivlersim.

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te nenit 108/A te LPP-se , sepse kerkesen tone per rishqyrtim te vendimit te Autoritetit Kontraktues e ka shqyrtuar komisioni I njejte vleresues, qe eshte ne kundërshtim me nenin e apostrofuuar , sepse komisioni vleresues nuk e perfageson Autoritetin Kontraktues e qe njekohesisht perben konflikt te interesit, por kerkesen tone eshte dashur ta shqyrtoj menaxheri i prokurimit.

Autoriteti Kontraktues perveq qe ka bere shkeljet e larte cekura gjithashtu ka bere shkeljen jo me pake te rende - parimit te ruajtjes se parase publike , sepse edhe pse oferta jone perveq qe ka qene dukshem me e ulet se sa e OE i rekomnaduar per shperblim me kontrate .

Te gjitha keto konstatime dhe prova te lartecekura vertetojne se Autoriteti Kontraktues ne rastin konkret ne mënyrë te vetedishme ka bërë shkelje flagrante te dispozitave te lartecekura te LPP-se, me qellim te eliminimit te kompanis tone dhe shperblimin me kontrat OE me cmim shume me te larte.

Nga te cekurat me lart i propozojme Organit Shqyrtues te Prokurimit qe ankesen tone ta aprovoj si te bazuar dhe lëndën ta kthej në rivleresim, ne menyre qe te evitohen shkeljet ligjore nga AK .

8. Dëmet materiale

Përshtetja mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

| |
|--|
| |
|--|

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*